

VENDIM
Nr. 92, datë 28.4.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “POWER COMM” SHPK PËR HEQJEN E
LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME
NR. 466, SERIA T20**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 5, germa “dh”; nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, germa “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 18, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 579/1 prot., datë 20.4.2022 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Power Comm’ sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 466, seria T20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 2.6.2020”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 92, datë 2.6.2020, ka licencuar shoqërinë “Power Comm” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Shoqëria “Power Comm” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 511/1 prot., datë 15.4.2022, ka bërë me dije se që nga data 9.3.2021, ka pezulluar aktivitetin e saj tregtar për arsye financiare (dokumentuar edhe me ekstraktin historik të saj të depozituar në ERE, nga i cili rezulton se statusi i shoqërisë është “Pezulluar”) dhe si e tillë kërkon edhe heqjen e licencës nr. 466, seria T20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 2.6.2020.

- Shoqëria ka dokumentuar edhe kryerjen e pagesës së rregullimit për vitin 2021 dhe rezulton se kjo shumë ka kaluar në llogarinë e ERE-s dhe shoqëria nuk është debitore ndaj pagesave të rregullimit.

- Kërkesa e shoqërisë “Power Comm” sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, mbështetet në parashikimet e nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në të cilin citohet se: “ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit”; si dhe nenit 5, germa “dh”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, e cila parashikon se: “Licenca hiqet me kërkesë të të licencuarit”.

- Në “Rregulloren për procedurat e heqjes së licencës në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, neni 7, paragrafi 2, përcaktohet se: “Në rast se nga i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat ‘dh’ dhe/ose ‘e’, të nenit 5, të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9, të kësaj rregulloreje”.

- “Rregullorja për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, në nenin 9, germa “d”, të saj, përcakton se: “... Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat ‘dh’ dhe/ose ‘e’, të nenit 5, të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje”.

- Në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, legjislacioni në fuqi i sipërcituar, i jep ERE-s të drejtën ligjore për t’u shprehur me një vendim miratimi pa kaluar më parë në fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Power Comm” sh.p.k. për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 466, seria T20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 2.6.2020.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi licenca me nr. 466, seria T20, humbet fuqinë juridike.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti